



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	<b>Nëntor 2022</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Donat Lushaku Drejtor i Drejtorisë së Kadastrit

**1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

Drejtoria e Kadastrit - Zyra Kadastrale Komunale (ZKK) e Prishtinës ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa me efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit **nëntor 2022** në zyrat pritëse janë pranuar gjithsej **2750** kërkesa, nga të cilat janë aprovuar **2464** kërkesa, refuzuar **9** dhe kanë mbetur në procedurë edhe **278**, të cilat janë realizuar përmes dy (2) sektorëve: sektorit të kadastrit dhe sektorit të gjeodezisë.

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.**

Aktivitetet e planifikuara të drejtorisë së kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastral
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave)
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licensuara
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

**3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

Në Drejtorinë e Kadastrit në Prishtinë gjatë muajit **nëntor 2022** nëpërmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, atij të kadastrit dhe gjeodezisë janë pranuar kërkesa të ndryshme prej të cilave:

**Në sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- **611** kërkesa për regjistrim të pronësisë prej të cilave janë aprovuar **402**, janë refuzuar **8** kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me **201** aktvendime për pezullim të përkohshëm të procedurës deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse.
- **5** kërkesa për historiate nga persona fizik, institucione.
- **288** shkresa kërkesa nga institucionet e ndryshme prej të cilat janë aprovuar te gjitha.
- **0** kërkesa për lirim të barrës tatimore dhe **7** kërkesa për vendosjen e barrës tatimore.
- **78** kërkesa për regjistrim të hipotekave dhe **60** kërkesa për çregjistrim hipoteke prej të cilave janë aprovuar të gjithat.
- **184** përmirësime/ankesa/ plotësim lënde nga institucionet e ndryshme prej të cilat janë aprovuar **139**, refuzuar **1** dhe në procedurë **45**.

**Totali i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë: 1234 nga të cilat 979 kërkesa janë aprovuar, 9 janë refuzuar dhe 246 kërkesa kanë ngelur në procedurë.**

**Në sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- **1278** kërkesa për certifikata të pronësisë dhe kërkesa për kopje të planit nga të cilat janë aprovuar të gjitha.
- **97** kërkesa për ndarje të parcelave nga prej të cilave janë aprovuar **85** dhe **12** kanë mbetur në procedurë.
- **36** kërkesa për bashkim të parcelave nga prej të cilave janë aprovuar **29** dhe **7** kanë mbetur në procedurë.
- **12** kërkesa për përcaktimi të kufijve nga prej të cilave janë aprovuar **9** dhe **3** kanë mbetur në procedurë.
- **11** kërkesa për ri-rregullimin e kufijve të parcelave nga të cilat janë aprovuar **9** dhe **3** kanë mbetur në procedurë.
- **35** kërkesa për identifikimin të parcelave-njësive banesore prej të cilave janë aprovuar **27** dhe **8** kanë mbetur në procedurë.
- **8** kërkesa për legalizimin e objekteve nga të cilat janë aprovuar të gjitha.
- **10** kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokave-parcelave nga të cilat janë aprovuar të gjitha.
- **4** plotësime të lëndëve nga të cilat janë aprovuar të gjitha.

- 6 kërkesë për regjistrim e objekteve dhe njësive banesore nga të cilat janë aprovuar te gjitha.
- 18 kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet si: Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Urbanizimit, Ministria e Planifikimit Hapësinor, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj, nga te cilat janë aprovuar te gjitha.

**Totali i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë: 1517 prej të cilave janë shqyrtuar 1485 dhe 32 kanë mbetur në procedurë**

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e Kadastrit ka implementuar mbi 90 përqind (%) të planit të saj duke i aprovuar, refuzuar dhe pezulluar kërkesat e palëve në procedurë sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve ka arritur të nxjerr vendime meritore për shumicën prej kërkesave të parashtruara nga palët / subjektet juridike.

***4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.***

Nga sektori i kadastrit aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër janë:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë punë që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral.
- Lëndët e dërguara në KPA verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave.
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, arkiv komunal ose ndërkomunal.

Nga sektori i gjeodezisë aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër janë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave.
- Lëndët për identifikimin e njësive banesore.
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

***4.1.1. STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.***

<b>Kërkesat e pranuar në drejtorinë e kadastrit muaji Nentor 2022</b>	<b>Numri total i kërkesave</b>	<b>Të aprovuara</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Në procedurë</b>	<b>Mjetet e grumbulluara €</b>
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	611	402	8	201	28,460.00
Kërkesa për historiate zyrtare, historiate për persona fizik dhe juridik	5	5	0	0	60.00
Kërkesa nga Institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe Institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	288	288	0	0	00
Vendosje të barrës tatimore dhe shënim te përmbarimit	7	7	0	0	00
Lirim nga barra tatimore dhe fshirje të shenimit të përmbarimit.	0	0	0	0	00
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	78	78	0	0	8,610.00
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	60	60	0	0	00
Kërkesa të tjera: përmirësime, ankesa, plotësime lënde etj.	184	139	1	45	590.00
Çertifikata të pronësisë & Kopje të planit	1278	1278	00	00	13,245.00
Ndarje-parcializimet copëtimet	97	85	00	12	8,850.00
Bashkimi i parcelave	36	29	00	7	13,695.00
Legalizimi i objekteve pa leje	8	8	00	00	0000.00
Identifikimi i parcelave dhe njërive banesore	35	27	00	8	730.00
Përcaktimi i kufijve të parcelave	12	9	00	3	678.00
Ri-rregullimi i kufijve të parcelave	11	9	00	2	1,148.00
Ndërrimi i destinimit të tokës-parcelave	10	10	00	00	17,516.00

Plotësimi i lëndëve	4	4	00	00	80
Regjistrimi i objekteve dhe njësive banesore	8	8	00	00	3872.000
Kërkesa zyrtare nga institucionet-Shërbimi i gjeodezisë (Certif, dhe Kopje e Planit)	18	18	00	00	0000.00
<b>Totali</b>	<b>2750</b>	<b>2464</b>	<b>9</b>	<b>278</b>	<b>97,534.00 €</b>

#### 4.1.2 Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastral përkundrazi kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

#### 4.1.3 Takimet me palë

- **Spektori i kadastrit** - zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP) ka rifilluar ti mbajë takimet me palë që mbahen një herë në javë (ditën e enjte), nga ora 10:00 deri në ora 12:00.
- **Spektori i gjeodezisë** - ka takime të rregullta me palë që mbahen një herë në javë (ditën e mërkure), nga ora 10:00 deri në ora 12:00.

#### 5.1.1 Diskutime Publike/Takimet me qytetarë - Nuk kemi pasur.

#### 5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

#### 6.1.1 Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër

- **Spektori i kadastrit:**
  - Lëndë të pranuar: **1234**
  - Lëndë të aprovuara: **979**
  - Lëndë të refuzuara: **2**
  - Lëndë në procedurë: **246**
- **Spektori i gjeodezisë:**
  - Lëndë të pranuar: **1517**
  - Lëndë të aprovuara: **1485**
  - Lëndë të refuzuara:
  - Lëndë në procedurë: **32**

#### 6. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

### **Sektori i kadastrit:**

- Sfiduese është komunikimi me institucionet, mos përgjigjet e tyre në afate ligjore të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- 20 kërkesa presin për - Verifikime në Arkiv Komunal dhe Ndërkomunal (lëndë nga muaj paraprak).
- 56 kërkesa presin për Verifikime në Gjykatë (lëndë nga muaj paraprak).
- 3 kërkesa presin për Verifikime në Privatizim (lëndë nga muaj paraprak).
- 6 kërkesa presin për Verifikime në NPB (lëndë nga muaj paraprak).
- 18 kërkesa presin për Verifikime në AKKVP (lëndë nga muaj paraprak).
- 51 kërkesa presin për Verifikim ne Noterët (lëndë nga muaj paraprak).

### **Sektori i gjeodezisë:**

- Sfiduese është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mos përgjigjet e tyre në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin **Cadastral Map** dhe **SIKTK** të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruimit të disa zonave kadastrale nga **Agjencia Kadastral e Kosovës**.

7. ***REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.***

### **Sektori i kadastrit:**

- Ndërrimi i pajisjeve teknologjike, printerë, skanerë, një telefon dalës për zyrën e juristëve, një kompjuter për takimet me palë.

### **Sektori i gjeodezisë:**

- Trajnime për punëtor.

8. ***AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues***

### **Sektori i kadastrit:**

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë punë.
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave.
- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, arkiv komunal ose ndër komunal dhe te noterët.

### **Sektori i gjeodezisë:**

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave)
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisë banesore
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licencuara
- Shqyrtimi i kërkesave/ ankesave të palëve dhe institucioneve.

9. *TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme*